

## SHËRBESA E MIROS SË SHENJTË

*Te Enjten e Madhe, kur kendohet, ne vent te Hymnit Kerubik, Tropari: "Ne darken tende mistike," dhe behet Hyrja e Madhe me Kungaten, del Pareprifti perpara Kungates, dyke mbajtur Poçen e Miros, te mbuluar me Mbulesen e Dhiskut, i percjellur nga njera ana dhe nga tjatra prej Dhjakesh, te cilet mbajne shtate çifte prej Ventalesh, dyke patur ne krye Domestikun dhe Dhjakun me llambadhe ne dore. Kur arrijne perpara Deres se Bukur, dy Ventalet e para hyjne ne Shenjteroren, sipas zakonit, po çiftet e tjera qendrojne nga njera ana dhe nga tjatra e Deres se Bukur perpara Alltarit. Pareprifti ia dorezón Poçen e Miros Patrikut ne Deren e Bukur, dhe Patriku e merr, dhe e ve me anen e mengjer te Tryezes se Shenjte. Pas Miros sillen brenda Dhuratat e Shenjta, dhe vazhdón Mesha sipas zakonit gjer sa thote Peshkopi:*

**PESHKOPI:** Dhe do te jene meshirat e Perendise dhe Shpetimtarit tone Jesú Krisht, me ju te gjithë.

*Pas kesáj Patriku vjen perpara Tryezes se Shenjte, zbulón Miron e Shenjte, e bekón tri here kryqthi, dhe thote me ze te unjur keté Urate:*

**PATRIKU:** O Zot i meshires dhe At i dríteve, prej te cilit vijne te gjitha dhuratat e mira dhe te

mbarúara, falna neve të pavyerve hirin për Sherbesen e këtij Misteri të math e jetëberes, si Moisiut edhe Samuelit edhe Apostujve të shenjta, dhe dërgoje Shpirtin e tërëshenjta mi këtij Miro. Bej-e krizme mbretërore, krizme shpirtërore, roje të jetës, shenjterim të shpërtheve dhe të trupeve, vaj ngazellimi, që përparoj në Ligje, po shkelqeu në Dhjatën e re; me të cilën janë lyer Priftërinjtë, Kryeprifterit, Profetet, edhe të gjithë atë, që u-pagëzuan prej syresh me banjen e perlindjes, si edhe Peshkopet e pastajmë, dhe Priftërinjtë, që u-perlindën gjer në ditën e sotme. Pó, o Kryezót, o Perëndí i tërëfuqishim, bekoje me permindodhjen e Shpirtit Shenjt, edhe bej-e robe qellore, shile mbarónjese, e cila vulós mi ballen e të pagëzuarve emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt; që të jenë përpara teje të njohur, gjirinj, qytetare dhe shërbetore të tu, të bekuar nga shpirti dhe nga trupi, të pagësuar nga gjithë ligësitë, të çliaruar nga gjithë mekatat; që të kenë roben e lavdisë sate dhe shenjen tënde të shenjta, dhe të njihen prej Engjëjve dhe Krye-ëngjëjve dhe prej gjithë Fórcave qellore; që tu japin tmerrin demónëve të prapë dhe të paudhë; që të behen pópulli yt i veçantë, komb i shenjta, prifterí mbretërore, të shiluar me anën e Misterit të shenjta; që të banojnë në zemrat e tyre Krishti yt edhe ti, o Perëndí dhe Atë, me Shpirtin Shenjt. Se i shenjta je, o Perëndia ynë, dhe i prehur në Shenjtoret, edhe ty të dërgojmë lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit

Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

PESHKOPI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tënde.

DHJAKU: Krerët tona Zotit le tja unjím.

PATRIKU: Ty, Perëndisë dhe Mbretit të gjithësisë, ta kemi unjór zëmër edhe kryet, se, ndónjëse jemi të pavyer, na vleresove të bëhemi shërbetore të Mistëreve të tua të shenjta; pra, e leçitim meshirën e pasur, që ke derdhur përmi në, dhe po e presim shenjterimin prej teje si Miro mi kokën tonë; se emri i Birit të vetëm, Krishtit, Perëndisë sonë, është Míroja e Shenjta, që aromatizoj tërë botën e dukur dhe të padukur. Dhe ty të dërgojmë lavdí dhe adhurím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jeteve. Amín.

*Pastáj Patriku e bekón kryqthi Miron, dhe e mbulón. Pastáj vazhdón Mesha, dhe Ventalet qëndrojnë gjer në kohën kur hapet Dera e Bukur pas Kungatores. Ahërë Patriku e merr Poçen e Miros, dhe ia dorëzón Parepriiftit nga Dera e Bukur. Pastáj Dhjakët me Ventalet shkojnë ashtú, sikunder arthne. Dhe Parepriifti e shtie Miron nga Poçja në enen, e cila ka brenda Nardín. Miroja e shenjta përbehet prej esencash aromatike të ndryshme të perziëra.*